



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. PH/A Prot.

Fier, më 10.05. 2023

Lënda: Dërgohet Raport Monitorimi për realizimin e shpenzimeve (anekset) Janar – Prill 2023.

**MINISTRISË E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR**

Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Fier

Bashkëlidhur ju dërgojmë Raportin e Monitorimit për realizimin e shpenzimeve (anekset), për periudhën Janar – Prill 2023 .

Duke ju falenderuar.

DREJTOR
Zaira Gjika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIAE PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

DREJTORIARAJONALEE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIERZYRA VENDORE E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

(periudha 01.01- 30.04.2023)

RAPORT MONITORIMI

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Fier ushtron aktivitetin e saj bazuar në VKM nr. 99, datë 27.02.2019“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar” dhe në Urdhërin të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr 234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”

Monitorimi i buxhetit të 4 mujorit të I të vitit 2023 është procesi i vlerësimit të performancës, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me treguesit e planifikuar dhe ka për qëllim:

- ❖ Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ❖ Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin veprimtarisë së IA-ve në pajtueshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ❖ Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në institucionet arsimore të varësisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- ❖ Të sigurojë që funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Të sigurojë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- ❖ Të ofrojë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- ❖ Të menaxhoj, mbikëqyr dhe të kontrolloj veprimtarinë IA-ve lidhur me zhvillimin e veprimtarive mësimore.
- ❖ Të monitorojë kualifikimet e personelit mësimdhënës të IA-ve për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- ❖ Të menaxhojë me përgjegjësi rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit korrekt të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”.
- ❖ Të organizojë dhe mbështes shërbimin psikosocial në institucionet arsimore publike.
- ❖ Të garantoj një administrim efikastë burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e ZVAP dhe IA-ve bazuar në formulën “për nxënës”.
- ❖ Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.
- ❖ Të monitorojë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- ❖ Të organizoj dhe mbështes zhvillimin dhe vlerësimin provimeve kombëtare në arsimin parauniversitar.
- ❖ Të inspektojë, monitorojë, vlerësojë, rekomandojë dhe të nxjerr përfundime mbi zbatueshmërinë e kritereve ligjore nga IA-të publike dhe private.
- ❖ Të mbledh dhe përpunoj të dhënat statistikore nga IA-të, në juridiksionin e saj.

- ❖ Të vendos mekanizma transparente te monitorimit të përdorimit të fondeve buxhetore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Të rrisë dhe zhvillojë kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese.

ZVAP Fier ka detajuar Buxhetin për vitin 2023 në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 84/2022, datë 24.11.2023 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ligjit nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar,

ZVAP Fier ka detajuar fondet e buxhetit të vitit 2023 mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023–2025 si dhe në prioritetet e përcaktuara në Programin e Qeverisë. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohet niveli i realizimit të fondeve buxhetore të ZVAP- së, të detajuara në nivel kategorie shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar, duke mundësuar kështu sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit. Strukturat e ZVAP Fier kanë kryer monitorimin e treguesve buxhetore me qëllim ndjekjen në vijimësi të objektivave të synuar në përputhje me planin strategjik të ecursisë së institucionit dhe të gjitha kërkesave ligjore. Detajimi i fondeve për vitin 2023 është realizuar sipas tre programeve buxhetore ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektivave të programit të Qeverisë Shtator 2020, objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2022 dhe strategjinë e arsimit parauniversitar, si dhe kërkesave për imlementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Tri programet e miratuara:

1. Programi “Planifikim Menaxhimi”
2. Programi “Arsimi Bazë”
3. Programi “Arsimi i Mesëm i Pergjithshëm”

Objektivat dhe reformat kryesore të realizuara nga ZVA Fier për periudhen Janar – Prill 2023:

*Financimit të shërbimit të transportit për rreth 536 nxënës që mësojnë në një distancë mbi 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe rreth 488 mësuesve që punojnë mbi 5km nga vendbanimi i tyre.

*Arsimimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara realizohet në klasa normale të arsimit bazë dhe te mesem ku ka të integruar 146 fëmijë më AK. Për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me AK janë vënë në dispozicion 95 mësues mbështetës. Është realizuar baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin parashkollor dhe bazë, si dhe është bërë kërkesa për mjete didaktike në institucionet eprore .

*Per dieta, pagesa (bileta, dieta hotel për trajnime) një fond prej 83,500 lekë. *Pagesa per likujdim të vendimeve gjyqësore periudhen Janar – Prill 2023 janë 0 lekë.

*U realizuanga IA perzgjedhja e teksteve shkollore për klasat 1,2,3,6,7,10,11,12 nga klasa e pare deri klasa e tretë të gjitha tekstet te reja falas, miratuar me VKM.

Një analizë më të detajuar për fondet e miratuara të ZVAP Fier dhe përdorimin e tyre për periudhen Janar – Prill 2023 sipas programeve dhe grup artikujve, ju paraqesim si më poshtë vijon :

Fondet e miratuara (të rishikuara) per ZVAP Fier deri ne periudhen Janar– Prill 2023, janë 398,770 në 000/leke.

Shpenzimet e realizuara të ZVAP Fier për periudhen Janar – Prill 2023 në raport me fondet vjetore të rishikuar janë 398,770 në 000/lekë, të realizuara në masen 35.53%.

